



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Prava

20/2024

Dështimi i Reformës në Drejtësi



Dhjetor, 2024

Autor: Gzim Shala

Me kontribut të veçantë të: Florian Smajli

Redaktorë: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) – Departamentit të Shtetit Amerikan, apo të National Endowment for Democracy (NED).

Implementuar nga:



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde



Mbështetur nga:



Rreth IKD:

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Dhjetor, 2024

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	7
2. Premtimi i madh: Reforma në drejtësi.....	8
3. Dështimi i madh: Reforma në drejtësi.....	9
4. Vetingu në drejtësi dhe polici	11
a. Heshtja për vetingun e policëve.....	14
5. Reforma në KPK	15
6. Konfiskimi i pasurisë së pajustificueshme	19
7. Deklarata e përbashkët e zotimeve	21
8. Dështimi strategjik.....	24
a. Kosova pa Strategji kundër Korrupsion	24
b. Strategjia për Sundimin e Ligjit.....	26
c. Planifikimi paradoksal.....	28
9. Mos prioritizimi buxhetor i drejtësisë	29

Shkurtesat

IKD – *Instituti i Kosovës për Drejtësi*

ZBE – *Zyra e Bashkimit Evropian*

KE – *Komisioni Evropian*

KPK – *Këshilli Gjyqësor i Kosovës*

KGjK – *Këshilli Gjyqësor i Kosovës*

GjK – *Gjykata Kushtetuese*

MD – *Ministria e Drejtësisë*

RFSSL – *Rishikimi Funkcional i Sektorit të Sundimit të Ligjit*

1. Përmbledhje ekzekutive

“Drejtësi dhe punësim” e përmbledhi fushatën parazgjedhore partia në pushtet Lëvizja Vetëvendosje. Premtimet dhe orientimi politik me të cilën partia në pushtet kandidoi në zgjedhjet e vitit 2021, programi qeverisës dhe fitorja me mbi 50% të votave të elektoratit që dolën në zgjedhje me 14 shkurt 2021, rritën pritjet e qytetarëve për reformë të thellë në drejtësi.

Përderisa vetingu dhe luftimi i korrupsionit ishin kryefjala me të cilën Qeveria aktuale erdhi në pushtet, asnjëra prej tyre nuk ndodhën. Qeveria dështoi ta bindë Komisionin e Venecias se në Kosovë nevojitet vetingu i plotë, ashtu që ky Komision rekomandoi vetëm veting të pjesshëm. Megjithatë, as vetingu i pjesshëm nuk u realizua. Madje, as nuk u fillua edhe përkundër faktit se Gjykata Kushtetuese (*tutje*: GjK) vlerësoi se amendamenti kushtetues lidhur me Vetingun është në pajtim me Kushtetutën e Kosovës. Ndërsa, sa i përket luftimit të korrupsionit, përgjatë gjithë mandatit të saj, Qeveria nuk arriti ta miratojë Strategjinë kundër Korrupsionit, duke vënë në dyshim publikun nëse vet Qeveria e kishte të njohur apo jo rrugën përmes të cilës do të ndërtonte vullnetin politik për të ndërmarr veprime për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin brenda kompetencave dhe përgjegjësi të saj.

Qeveria premtoi dhe bëri përpjekje për shuar korporatizmin brenda Këshilli Prokurorial të Kosovës (*tutje*: KPK), për të reformuar këtë institucion... Mirëpo, GjK konstatoi se Kuvendi shkeli kushtetutën në rastin e reformës në KPK. Njëjtë si GjK, edhe Komisioni i Venecias përmes opinionëve ligjore konstatoi se mënyra e propozuar nga qeveria për reformën në sistemin prokurorial cenonte parimet e sundimit të ligjit dhe hapte rrugë për politizimin e KPK. Nuk munguan as reagimet e partnerëve ndërkombëtarë duke shprehur mos pajtim me mënyrën se si Ministria e Drejtësisë (*tutje*: MD) e menaxhoi këtë proces. Eksperimentet dhe vonesat e shumta bënë që kjo reformë të prolongohej. Qeveria dhe shumica parlamentare mungesën e rezultateve e kompensoi me sulme të paprecedenta ndaj GjK, sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Projektligji për Byronë u karakterizua si proces jo transparent i cili nuk përmbushte kërkesat për konsultim minimal publik. Miratimi i këtij Projektligji për herë të dytë, përmes një seance të përshpejtuar, pa debat dhe konsultime publike brenda dy leximeve, ngrit perceptimin e përdorimit të këtij Ligji për qëllime elektorale. I njëjti ligj disa here ishte konsideruar kundërkushtetues nga GjK dhe nga Komisioni i Venecias se i njëjti nuk plotësonte standardet e sundimit të ligjit dhe parimet që sigurojnë të drejtat dhe liritë e njeriut.

MD ka dështuar po ashtu të përmbyllë procesin në lidhje me Projektligjet të cilat dalin nga deklarata e përbashkët e zotimeve, duke e lënë gjyqësorin pa ligje jashtëzakonisht të nevojshme për cilësinë e drejtësisë dhe llogaridhënien e akterëve të sistemit të drejtësisë.

Qeveria trashëgoi një proces jashtëzakonisht të rëndësishëm: Rishikimin Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit. Bazuar në këtë proces, qeveria miratoj Strategjinë për Sundimin e Ligjit (*tutje*: SSL) 2021-2026. Por, Qeveria dështoi ta mbajë të paktën aktive këtë Strategji: Dështimi i saj për

të rishikuar atë e bëri SSL-në një dokument të pazbatueshëm në praktikë. MD dështoi të miratoj planin e veprimit për vitin 2024 të kësaj strategjie.

Kështu, përgjatë mandatit të saj, Qeveria dështoi plotësisht në reformimin e drejtësisë, duke mos bërë asnjë progres në këtë drejtim. Përkundrazi, duke rrezikuar regres të konsiderueshëm, përmes draftimit të ligjeve të cilat përmbajnë shkelje kushtetuese dhe probleme të shumta serioze.

2. Premtimi i madh: Reforma në drejtësi

Vitet 2021–2024 nga raporte vendore dhe ndërkombëtare u karakterizuan me mungesë të rezultateve në luftimin e korrupsionit të profilit të lartë, me pak progres në luftën kundër krimit të organizuar, vlerësime negative në lidhje me sistemin e drejtësisë, skandale të shumta brenda sistemit të drejtësisë dhe dështimi i mekanizmave të brendshëm të sistemit të drejtësisë për ngritje të llogaridhënies. Republika e Kosovës për më shumë se dy vite funksionon me U.D. së Kryeprokurorit të Shtetit dhe me mungesë të vullnetit të KPK për të adresuar këtë çështje përkundër rekomandimeve të Raportit të Komisionit Evropian (*tutje*: KE) për Kosovën për dy vite me rradhë. Krejt këto lidhen me kërkesën për reformë të thellë në sistemin e drejtësisë. Ndër vite, vazhdimisht është theksuar se Kosova ka një infrastrukturë adekuate ligjore, por se problematike është mungesa e zbatimit të ligjeve në praktikë. Partia në pushtet që udhëheq me qeverinë erdhi në pushtet me premtimin e madh për reformë të thellë në sistemin e drejtësisë. Kryeministri aktual kishte përmbledhur fushatën e tij parazgjedhore me dy (2) fjalë: Drejtësi dhe punësim.

Programi i partisë në pushtet, premtonte reformë të thellë në sistemin e drejtësisë. Këtu bënte pjesë vetingu i plotë në sistemin e drejtësisë dhe vetingu në nivelet e larta të Policisë së Kosovës¹. Duke premtuar përkushtim në luftën kundër korrupsionit, plan programi premtonte ngritje të resurseve të sistemit të drejtësisë.

“Do të fokusohemi në luftimin e krimit e korrupsionit” theksonte Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025. Tutje, përmes këtij programi, Qeveria premtonte se do të angazhohej në vazhdimësi për reformimin e drejtësisë penale, civile dhe administrative, që synojmë ta arrijmë nëpërmjet ndryshimit të politikave dhe kornizës ligjore përkatëse. Edhe ky dokument premtonte procesin e vetingut².

¹ Programi zgjedhor i LVV-së, “*Prioritet për krejt qytetarët DREJT së ardhmes*”; fq. 27 dhe 35; shkurt 2021, (Shih linkun: <https://www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2024/08/Prioritetet-per-KREJT-qytetaret-Drejt-se-ardhmes.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

² “*Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021 – 2025*”; fq. 5 dhe 12; maj 2021, (Shih linkun: <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/06/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

Kështu, drejtësia ishte kryefjala e asaj me të cilën Qeveria aktuale erdhi në pushtet., Nisur nga premtimet e dhëna dhe rezultati më i lartë zgjedhor ndonjëherë në Kosovë, Qeveria kishte ndërtuar pritje të larta për reformën në sistemin e drejtësisë.

Premtimet mbetën në letër dhe nuk u realizuan. Kosova humbi katër vite dhe reformat në sistemin e drejtësisë kanë mbetur në status quo. Vetingu i shumë premtuar ka ngecur në Kuvendin e Kosovës në mungesë të votave për të kaluar këtë proces kaq të rëndësishëm, reforma në sistemin prokurorial ka ngecur, Kodi Civil ka mbetur në sirtarë sikurse edhe Strategjia kundër Korrupsion.

3. Dështimi i madh: Reforma në drejtësi

Qeveria aktuale nuk erdhi në pushtet për të adresuar problemet eventuale ligjore. Ajo erdhi në pushtet me premtimin për reforma të thella në drejtësi.

Fatkeqësisht, asgjë nga kjo nuk u arrit. Përgjatë gjithë mandatit të saj, Qeveria funksionoi pa Strategji kundër Korrupsion, madje pati pengesa serioze edhe në zbatimin e SSL. Vetingu nuk filloi asnjëherë, reforma në KPK nuk u jetësua, ndërsa mënyra se si u veprua vazhdimisht me Ligjin për Byronë ngritë dyshime serioze për keqpërdorim të këtij ligji për efekte elektorale.

Sa i përket vetingut, përball premtimit që ky proces të ndodhë, i njëjti nuk filloi asnjëherë. Madje, Qeveria dështoi të bindë Komisionin e Venecias në atë që kishte premtuar: Realizimin e vetingut të gjerë ndaj të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve.

GjK³⁴ konstatoi se Kuvendi shkeli kushtetutën në rastin e reformës në KPK. Në dy (2) opinione, probleme të shumta u konstatuan edhe nga Komisioni i Venecias. Eksperimentet dhe vonesat e shumta bënë që kjo reformë të prolongohej. Qeveria asnjëherë nuk bëri vetëkritikë për dështimin e këtij procesi, përkundrazi filloi sulmet e paprecedenta ndaj GjK dhe sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Projektligji për Byronë u karakterizua si proces jo transparent dhe i cili nuk përmbushte kërkesat minimale për konsultim publik. Miratimi i këtij Projektligji për herë të dytë, përmes një seance të

³ Aktgjykim në rastet nr. KO100/22 dhe KO101/22 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës; par. 32 – 34; Prishtinë, 5 prill 2023; (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71948>); (Qasur për here të fundit më 7 dhjetor 2024).

⁴ Komisioni i Venecias, “Opinion on the Draft Amendments to the Law on the Prosecutorial Council”; Miratuar nga Komisioni i Venecias në Seancën Plenare të 129-të; Venecia, 10 – 11 dhjetor 2021; (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2021\)051-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2021)051-e)); (Qasur për here të funit më 7 dhjetor 2024).; Komisioni i Venecias, “Follow-Up Opinion to the Previous Opinions Concerning Amendments to the Law on the Kosovo Prosecutorial Council”, Miratuar nga Komisioni i Venecias në Seancën Plenare të 137-të; Venecia, 15 – 16 dhjetor 2023; (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2023\)043-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2023)043-e)); (Qasur për here të funit më 7 dhjetor 2024).

përshpejtuar, pa debat dhe punime brenda dy leximeve, ngrit perceptimin e përdorimit të këtij Ligji për qëllime elektorale. Paraprakisht, i njëjti i ligj u konstatua si kundërkushtetues⁵ derisa në disa raste u evidentuan probleme të shumta nga Komisioni i Venecias.⁶

MD ka dështuar po ashtu të përmbyllë procesin në lidhje me Projektligjet të cilat dalin nga deklarata e përbashkët e zotimeve. Kjo situatë e ka lënë gjyqësorin pa ligje jashtëzakonisht të nevojshme, mungesa e të cilave ka efekte negative në raport me cilësinë e drejtësisë dhe llogaridhënien e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Si asnjëherë më parë, Gjykata Kushtetuese anuloi një numër të madh të ligjeve të miratuara si kundër kushtetuese, derisa në shumë Projektligje edhe vet IKD i evidentoi shkelje kushtetuese. Kështu, përballë sigurisë që do duhej të ndjente drejtësia në raport me Qeverinë e cila ka ardhur në pushtet me premtimin për drejtësi, pikërisht drejtësia është vënë shpesh në pikëpyetje. Kjo duke miratuar ligje të cilat nuk janë në përputhje me Kushtetutën dhe ligje të cilat cenonin sigurinë juridike.

Qeveria në pushtet po e përfundon mandatin pa Strategji kundër Korrupsionit. Është paradoksale qasja e një Qeverie që vie në pushtet me premtimin për luftimin e korrupsionit gjersa për gjatë gjithë mandatit të saj nuk arrin ta miratojë Strategjinë kundër Korrupsionit.

Në kuptimin e Strategjive, është pikërisht dështimi i Qeverisë duke mos i kushtuar rëndësie që ka SSL, duke dështuar të njëjtën ta zbatoj në praktikë në bazë të objektivave dhe qëllimit për të cilin ishte miratuar. Këtu bëhet fjalë për një dokument të jashtëzakonshëm, të dalë nga një proces adekuat si Rishikimi Funkcional i Sektorit të Sundimit të Ligjit (tutje: RFSSL), të cilin e trashëgoi Qeveria aktuale.

Gjatë Javës kundër Korrupsion 2023, IKD kishte deklaruar se “Në pushtet është një Qeveri e cila nëse e analizojmë përgjatë këtyre tri viteve qartazi mund të themi që ka pasur një ligjbërje të zakonshme. Në asnjë rast ne nuk e shohim reformën në drejtësi as reformën për drejtësi as në fusha

⁵ Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese në rastin KO46/23 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme; Prishtinë, 29 korrik 2024; (Shih linkun: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2024/07/ko_46_23_agj_shq.pdf); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

⁶ Komisioni i Venecias, “Opinion on the Draft Law N°08/L-121 on the State Bureau for Verification and Confiscation of Unjustified Assets”, Miratuar nga Komisioni i Venecias në Seancën Plenare të 131-të; Venecia, 17 – 18 qershor 2022; (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2022\)014-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2022)014-e)); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).; Komisioni i Venecias, “Follow-Up Opinion to the Opinion on the Draft Law N°08/L-121 on the State Bureau for Verification And Confiscation Of Unjustified Assets”, Miratuar nga Komisioni i Venecias në Seancën Plenare të 133-të, 16-17 dhjetor 2022. (Shih linkun [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2022\)052-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2022)052-e)). (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

të tjera”. Megjithatë, nga një ri analizë pas një viti, kur Qeveria në pushtet po përfundon mandatin e saj, del se niveli i operimit shkon nën vlerësimin “ligjberje e zakonshme”⁷.

Disa nga ligjet e rëndësishme të miratuara nga Qeveria dhe Kuvendi gjatë mandatit Qeverisës, janë iniciativa të trashëguara nga Qeveritë paraprake. Numri i këtyre ligjeve nuk është i vogël. Kështu bëhet fjalë për Kodin e Procedurës Penale, Ligjit për Gjykatën Komerciale, Ligji për Agjencinë kundër Korrupsionit, Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik etj. Kështu, në kuptim të reformimit të sistemit të drejtësisë, përjashtimisht Ligji për Gjykatën Administrative, nuk ka ndonjë iniciativë të madhe ligjore e cila ka përfunduar me sukses nga Qeveria në pushtet.

Çështja e reformës në drejtësi u kritikua edhe nga Komisioni Evropian në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën. Sipas këtij raporti, “vonesat dhe përpjekjet për të dizajnuar së bashku reformat në drejtësi në përputhje me deklaratën e përbashkët të zotimeve të marsit 2023 tregojnë një mungesë të përsëritur të vullnetit për të forcuar sistemin e drejtësisë. Konsultimet mbi këto reforma dhe mbi ndryshimet në ligjin për KPK ishin të nxituara dhe nuk siguruan një shqyrtim domethënës. Pavarësisht këshillave të fuqishme të BE-së, Komisioni i Venecias nuk u konsultua nga qeveria dhe kuvendi mbi ndryshimet përfundimtare në ligjin për KPK dhe mbi reformat e tjera kyçe. Kjo ndikoi negativisht në cilësinë e legjislacionit dhe përshtatshmërinë e tij me standardet evropiane”⁸.

4. Vetingu në drejtësi dhe polici

Bazuar në gjetjet e identifikuara gjatë procesit të hulumtimit, që nga viti 2012, IKD ka kërkuar zhvillimin e procesit të vetingut në sistemin e drejtësisë.

Në premtimet e Qeverisë për luftimin e korrupsionit, zhvillimi i procesit të vetingut është premtimi bazë. Programi zgjedhor i Lëvizjes Vetëvendosje me të cilin kishte kandiduar në zgjedhjet e vitit 2021 theksonte se “Pjesë integrale dhe e domosdoshme e sistemit të drejtësisë është gjyqësori i pavarur, i paanshëm, me integritet dhe efikas. Për të arritur këtë, nivelet më të larta hierarkike të

⁷ “Fillon “Java Kundër Korrupsionit 2023”, diskutohet për reformën në sistemin e drejtësisë”; Instituti i Kosovës për Drejtësi, Prishtinë, 5 dhjetor 2023; (Shih linkun; <https://kli-ks.org/fillon-java-kunder-korrupsion-2023-diskutohet-per-reformen-ne-sistemin-e-drejtësisë/>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024)..

⁸ “Raporti për Kosovën 2024”; fq. 26; Komisioni Evropian; Bruksel, 30.10.2024; (Shih linkun: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43e1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf). (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

sistemit të drejtësisë dhe jo vetëm, do t'i nënshtrohen procesit të vetingut”⁹. Ky zotim u dha edhe në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2021-2025¹⁰.

Në tetor të vitit 2021, Qeveria e Republikës së Kosovës aprovoi Koncept-Dokumentin për Zhvillimin e procesit të vetingut në sistemin e drejtësisë. Ky koncept dokument ishte përcaktuar në modelin e vetingut përmes ndryshimeve kushtetuese që mundëson vetingun nga një trup ad-hoc dhe më pastaj vazhdimin e vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë në kuadër të KGjK dhe KPK¹¹.

Sa i përket afatit kohor për zhvillimin e procesit të vetingut, bazuar në koncept dokumentin e miratuar nga Qeveria, nga koha e miratimit të tij e deri më tani, ky proces tani do duhej të ishte në një fazë shumë të avancuar. Në bazë të këtij plani, do duhej që tanimë vetingu të ishte i përfunduar për gjyqtarët dhe prokurorët e shkallëve më të larta, derisa aktualisht do ishte në zhvillim e sipër procesi i vetingut ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të niveleve themelore të Gjykatave dhe Prokurorive¹².

Përderisa sipas Koncept-Dokumentit ne do të duhej të kishim hyrë drejt fundit të procesit të vetingut, realiteti në praktikë është diametralisht i kundërt: Vetingu nuk ka filluar. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, ky proces nuk ka filluar asnjëherë.

Në tetor të vitit 2021, kishte folur edhe shefi i ZBE-së atë kohë, Tomas Szunyog rreth këndëvshtrimeve të ndryshme që kishin shfaqur për procesin e vetingut, duke thënë se nuk kanë probleme me qeverinë e Kosovës sa i përket sistemit të drejtësisë. Ai kishte theksuar se thjeshtë kërkojnë koordinim dhe konsultim për hapat e qeverisë¹³.

Përballë dështimit për të realizuar vetingun në praktikë, Qeveria e Republikës së Kosovës madje ka dështuar ta bindë Komisionin e Venecias se në Kosovë ka nevojë të zhvillohet vetingu ndaj të gjithë akterëve të sistemit të drejtësisë, ashtu siç kishte premtuar se do ta bëjë. Në qershor 2022, Komisioni i Venecias publikoi opinionin në lidhje me koncept dokumentin për vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe draft amendamenteve kushtetuese. Sipas Komisionit të Venecias, “Sipas Koncept Dokumentit nuk është mjaftueshëm e qartë pse është i nevojshëm një vetting i

⁹ Programi zgjedhor i LVV-së, “Prioritet për krejt qytetarët DREJT së ardhmes”, fq. 27, shkurt 2021, (Shih linkun: <https://www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2024/08/Prioritetet-per-KREJT-qytetaret-Drejt-se-ardhmes.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

¹⁰ “Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021 – 2025”, fq. 12, maj 2021, (Shih linkun: <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/06/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

¹¹ “Koncept dokumenti për zhvillimin e procesit të Vetingut në sistemin e drejtësisë”, fq. 287, shtator 2021, (Shih linkun: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Koncept-dokument-per-Zhvillimin-e-procesit-te-vetingut-ne-sistemin-e-dre....pdf>), (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

¹² Po aty, fq.257-286.

¹³ “Szunyog: BE s'ka probleme me Qeverinë, kërkojmë më shumë koordinim për reformën në drejtësi”, Telegrafi; 29 tetor 2021; Shih linkun: <https://telegrafi.com/szunyog-ska-probleme-qeverine-por-kerkojme-shume-koordinim-per-reformen-ne-drejttesi/>; (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024)

përgjithshëm për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët, duke krijuar trupa ad hoc për vetting, nëse një pjesë e rëndësishme e problemit lidhet me zbatimin joefikas të legjislacionit dhe zbrastësitë ligjore”. Në këtë opinion, Komisioni i Venecias theksoi se “draft amendamentet kushtetuese që janë përgatitur sipas Opsionit 5, madje edhe në versionin e tyre të rishikuar dhe të shkurtuar, shkojnë shumë larg duke parashikuar një vetting për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët; amendamentet kushtetuese, kur është e nevojshme, duhet të sigurojnë vetëm kontrolle të integritetit për anëtarët e KGJK dhe KPK, kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët”¹⁴. Kështu, Qeveria nuk arriti të bind Komisionin e Venecias se nevojitet vetting ndaj të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve.. Kështu, Komisioni i Venecias theksoj se procesi i vettingut duhet të shtrihet vetëm ndaj anëtarëve të KGJK dhe KPK Kryetarëve të Gjykatave dhe Kryeprokurorëve.

Përkundër dështimit të Qeverisë që të bind Komisionin e Venecias për atë çfarë kishte premtuar, edhe vetingu vetëm ndaj krerëve institucional nuk mund të konsiderohet i padobishëm. Në fakt, për disa aspekte, në disa raste ky lloj vetingu konsiderohet se ka shumë përparësi në raport me një vetting të plotë ndaj të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Vetingu i kufizuar vetëm në krerët e sistemit të drejtësisë verifikon anëtarët e një pjese të sistemit të drejtësisë të cilët janë të mandatuar të ngritin llogaridhënien ndaj pjesës tjetër të sistemit të drejtësisë. Kështu, pas zhvillimit të këtij lloj vetingu, do të ngritej besueshmëria në mekanizmat e brendshëm të sistemit të drejtësisë, të cilët do të siguronin llogaridhënie për pjesën tjetër të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Vetingu i pjesshëm është proces më i parashikueshëm dhe shumë më lehtë i menaxhueshëm. Nga ky proces kërkohet vlerësimi i më pak se 50 akterëve të sistemit të drejtësisë, shumica prej të cilëve nuk janë të angazhuar drejt për së drejti në trajtimin e rasteve konkrete. Kështu, ky proces do të zhvillohej më shpejtë dhe nuk do të kishte efekte në administrimin e drejtësisë.

Në shtator të vitit 2022, Qeveria i dorëzoi Kuvendit dosjen në lidhje me procesin e vettingut¹⁵. Me 2 mars 2023, Kryetari i Kuvendit i referoi draft amendamentet kushtetuese për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese. Në janar 2024, Gjykata vendosi që, me një përjashtim, draft amendamentet kushtetuese nuk pakësojnë të drejtat e njeriut të garantuara me kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës¹⁶.

¹⁴ Komisioni i Venecias, “*Opinion on the concept paper on the vetting of judges and prosecutors and draft amendments to the Constitution: Kosovo*”, par. 123 – 126, Venecia, 17-18 qershor 2022, e miratuar në seancën plenare të 131-të, (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2022\)011-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2022)011-e)). (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

¹⁵ https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2024/01/ko_55_23_agj_shq.pdf - par.42

¹⁶ Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese në rastin KO55/23 - Vlerësimi i amendamenteve të propozuara kushtetuese, të referuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 2 mars 2023, par. 6; Prishtinë; 25 janar 2024; (Shih linkun: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2024/01/ko_55_23_agj_shq.pdf); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

Kështu, Gjykata Kushtetuese i dha dritën e gjelbër miratimit të draft amendamenteve kushtetuese që krijojnë bazën kushtetuese për zhvillimin e vetingut në sistemin e drejtësisë. Megjithatë, kjo asnjëherë nuk ndodhi: Draft amendamentet mbetën drafte dhe nuk u miratuan asnjëherë. Pra, megjithatë ky proces ende nuk ka filluar fare.

a. Heshtja për vetingun e policëve

Në një raport të publikuar në vitin 2018, IKD theksonte se “në këtë situatë të krijuar, e cila shihet e pashpresë, është nevojë e domosdoshme që Kosova të fillojë me veprime konkrete drejt procesit të vetingut në Polici, Prokurori dhe Gjykata”¹⁷. Në këtë raport, IKD dëshmonte nevojën për zhvillimin e procesit të vetingut edhe në Policinë e Kosovës.

Këtë premtim e dha edhe partia në pushtet, e cila në programin me të cilin garantonte në zgjedhjet e vitit 2021, theksoi se “nivelet e larta drejtuese të policisë do t’i nënshtrohen procesit të vetingut”¹⁸. “do të zhvillojmë procesin e vetingut për sistemin e drejtësisë dhe të institucioneve të rendit dhe sigurisë publike”¹⁹. Në lidhje me zhvillimin e vetingut në Policinë e Kosovës, Koncept Dokumenti për Zhvillimin e Procesit të Vetingut në sistemin e drejtësisë theksoj se “Duke qenë se “vetingu” në Polici të Kosovës, Inspektorat Policor të Kosovës, AKI dhe institucione tjera bie jashtë kompetencës së Ministrisë së Drejtësisë, zhvillimi i procesit në këto institucione iu mbetet institucioneve përkatëse”²⁰.

Megjithatë, asnjë institucion përkatës më nuk e trajtoi këtë çështje. Përballë premtimeve se kjo do të ndodhë, Qeveria e Republikës së Kosovës heshturazi u shmang nga kjo iniciativë, duke mos ndërmarrë asnjë veprim të vetëm për zhvillimin e procesit të vetingut në Policinë e Kosovës.

¹⁷ “*Vetingu pa alternativë (Analizë e “kapjes” së Policisë, Prokurorisë dhe Gjyqësorit nga politika dhe grupet e interesit në Kosovë*”, Instituti i Kosovës për Drejtësi dhe Instituti Columbus; fq. 45; Prishtinë; dhjetor 2018; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/01/3.-Vetingu-pa-alternative.pdf>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

¹⁸ Programi zgjedhor i LVV-së, “*Prioritet për krejt qytetarët DREJT së ardhmes*”, fq. 35, shkurt 2021, (Shih linkun: <https://www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2024/08/Prioritetet-per-KREJT-qytetaret-Drejt-se-ardhmes.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

¹⁹ “*Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021 – 2025*”, fq. 18, maj 2021, (Shih linkun: <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/06/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

²⁰ “*Koncept dokumenti për zhvillimin e procesit të Vetingut në sistemin e drejtësisë*”, fq. 52, shtator 2021, (Shih linkun: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Koncept-dokument-per-Zhvillimin-e-procesit-te-vetingu-ne-sistemin-e-dre...pdf>), (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024)

5. Reforma në KPK

KPK përmes mungesës së transparencës dhe llogaridhënies tanimë ka mirë ndërtuar një kulturë të pandëshkueshmërisë brenda saj. Përballë rolit kushtetues dhe ligjor që ka, ky institucion nuk ka arritur që të luaj rolin e tij, duke i kontribuar mungesës së transparencës dhe llogaridhënies.

Duke qeverisur me një mendësi korporatiste, proceset e KPK për rekrutimin dhe avancimin e prokurorëve janë kontestuar pothuajse tash e një dekadë²¹. KPK e ka barazuar shkeljen e së drejtës në jetë me ulje të pagës për 30%²², ka dështuar të sigurojë proces meritore për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të ri të Shtetit²³ etj.

Në këtë situatë, reforma në KPK paraqet një domosdoshmëri për institucionet e sistemit të drejtësisë. Kështu, për vite me radhë, sistemi prokurorial i Kosovës nuk i është përgjigjur nevojës së shoqërisë kosovare përballë rolit që ka. Sistemi prokurorial i Kosovës ka dështuar në gjenerimin e rezultateve konkrete në luftimin e korrupsionit të profilit të lartë, derisa në shumë raste është përfshirë në skandale të shumta të cilave nuk i ka dhënë përgjigje.

Përgjatë gjithë mandatit të saj qeverisës, Qeveria Kurti II është duke tentuar të realizoj reformën në sistemin prokurorial të Kosovës. Megjithatë Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për KPK është miratuar për herë të dytë, i njëjti nuk ka hyrë ende nuk fuqi, për shkak të dërgimit të tij për vlerësim nga Gjykata Kushtetuese²⁴.

Sipas Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, ligj ky tanimë i shfuqizuar, i cili ishte miratuar në vitin 2010, KPK përbëhej nga nëntë (9) anëtarë, pesë (5) prej të cilëve prokurorë²⁵. Kjo përbërje zgjati deri më 1 janar 2016, kur numri i anëtarëve të KPK u rrit në 13. Kjo rritje u bë në favor të prokurorëve. Sipas Ligjit të ndryshuar, KPK do të përbëhej nga 13

²¹ "Dekada e shkeljeve sistematike të KPK-së", Betimi për Drejtësi, 21 Shtator 2024. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/betimi-per-drejtesi-374-dekada-e-shkeljeve-sistematike-te-kpk-se/>). (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

²² "Kushtetuesja konstatoi se i ishte shkelur e drejta për jetë Sebahate Morinës, KPK mjaftohet me 30% ulje të pagës për prokuroren Hava Krasniqi", Betimi për Drejtësi, 30 janar 2024. <https://betimiperdrejtesi.com/kushtetuesja-konstatoi-se-i-ishte-shkelur-e-drejta-per-jete-sebahate-morines-kpk-mjaftohet-me-30-ulje-te-pages-per-prokuroren-hava-krasniqi/> (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2024).

²³ IKD, GLPS dhe FOL, "Integriteti i procesit të përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit", Mars 2022. (Shih linkun https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/03/IKD-GLPS-FOL_Raporti-Final_Procesi-per-Kryeprokuror-te-Shtetit-1.pdf). (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).; "IKD, FOL dhe INPO: KPK të shpallë sa më parë konkursin e ri për Kryeprokuror të Shtetit", 4 mars 2024. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ikd-fol-dhe-inpo-kpk-te-shpalle-sa-me-pare-konkursin-e-ri-per-kryeprokuror-te-shtetit/>). (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

²⁴ "PDK-ja i dërgon në Kushtetuese Ligjin për KPK-në, KPM-në dhe Statutin e UP-së"; Betimi për Drejtësi; 18 korrik 2024; (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/pdk-ja-i-dergon-ne-kushtetuese-ligjin-per-kpk-ne-kpm-ne-dhe-statutin-e-up-se/>).

²⁵ Ligji Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, neni 5.

anëtarë, 10 prej të cilëve nga radhët e sistemit prokurorial²⁶. Ligji NR. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i cili aktualisht është në fuqi, e ka ruajtur këtë përbërje²⁷.

Në raport me përbërjen aktuale të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Komisioni i Venecias nënvizoi se: “KPK-ja aktuale përbëhet pothuajse tërësisht nga prokurorë dhe për këtë arsye është e prirur ndaj rrezikut të korporatizmit. Për më tepër, në Kosovë, shumica e anëtarëve prokurorialë të KPK-së vijnë nga zyrat prokuroriale të niveleve të ulëta. Është krejtësisht e natyrshme që, edhe në mungesë të një lidhje formale subordinimi, ata mund të perceptohen se votojnë së bashku me kolegët e tyre të nivelit më të lartë, dhe në veçanti me Kryeprokurorin e Shtetit. Siç kanë dëshmuar disa OJQ, pikërisht kështu ka funksionuar KPK-ja në të kaluarën”. Për këtë arsye, Komisioni i Venecias theksoi se reduktimi i përqindjes së anëtarëve prokurorialë mund të ndihmojë në luftimin e tendencës korporatiste të këtij organi, ose perceptimit të një tendence të tillë. Megjithatë, ky reformim nuk duhet të çojë në nënshtrimin e KPK ndaj shumicës qeveritare të Kuvendit të Republikës së Kosovës²⁸. Çështja e përbërjes korporatiste të KPK, ndonëse nuk u emërtua si e tillë në rastin konkret, ishte trajtuar edhe gjatë procesit të RFSSL²⁹.

Më 26 tetor 2021, Ministria e Drejtësisë, pasi kishte hartuar projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik, iu drejtua Komisionit të Venecias. Pas Opinionit të parë të Komisionit të Venecias, në shkurt 2022, Qeveria hartoi dhe miratoi draftin e dytë të projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik. Më 25 shkurt 2022, Qeveria kërkoi një Opinion të dytë nga Komisioni i Venecias, për tu siguruar nëse drafti final i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik, kishte adresuar vërejtjet dhe rekomandimet e Opinionit të parë. Më 9 mars 2022, Qeveria, miratoi projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për KPK³⁰. Me 22 mars 2022, Komisioni i Venecias publikoi opinionin e dytë përkitazi me këtë Projektligj³¹. Më 23 qershor 2022, Kuvendi miratoi Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për KPK. Sipas këtij Ligji, KPK do të përbëhej nga shtatë (7) anëtarë: katër (4) prokurorë dhe tre (3) jo prokurorë³².

Më 1 korrik 2022, PDK dhe LDK e dërguan Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për KPK për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese. Nëntë (9) muaj pas, me 5 prill 2023, Gjykata

²⁶ Ligji Nr. 05/L-035 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës; Neni 3, par. 1

²⁷ Ligji Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, neni 9, par. 1

²⁸ Po aty, par.27

²⁹ Dokumenti llogaridhia, f.41-42

³⁰ Aktgjykim në rastet nr. KO100/22 dhe KO101/22 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës; par. 32 – 34; Prishtinë, 5 prill 2023; (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71948>); (Qasur për here të fundit më 7 dhjetor 2024).

³¹ Komisioni i Venecias, “*Opinion on the revised draft amendments to the Law on the Prosecutorial Council*”; Miratuar nga Komisioni i Venecias në Seancën Plenare të 130-të; Venecia, 18 – 19 mars 2022; (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2022\)006-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2022)006-e)); (Qasur për here të funit më 7 dhjetor 2024).

³² Aktgjykim në rastet nr. KO100/22 dhe KO101/22 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës; fq. 34; Prishtinë, 5 prill 2023; (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71948>); (Qasur për here të fundit më 7 dhjetor 2024).

Kushtetuese vlerësoi se Ligji në fjalë nuk ishte në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, duke e shfuqizuar në tërësi këtë ligj³³.

Pas vendimit të GjK e cila rrëzoi tërësisht Ligjin për Këshillin Prokurorial, Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, mbajti konferencë për media sipas së cilës GjK po e sheh më të rëndësishëm interesin individual të anëtarëve të KPK se sa interesin e përgjithshëm³⁴. Kjo deklaratë përbënte ndërhyrje në punën e GjK³⁵.

Pas aktgjykimit të GjK, Qeveria u fut në eksperimente, përmes të cilave rrezikohej pavarësia e KPK. Më 12 korrik 2024, Qeveria e Kosovës miratoi një version të ri të Projektligjit për KPK, i cili shtoi numrin e anëtarëve në 19 deri më 2026, përkundër qëllimit fillestar për reduktimin e tyre. Ndryshimet e reja përfshijnë përfshirjen e anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi, të cilat përbënin politizim të institucionit dhe shkelje të Kushtetutës, SSL-së dhe opinioneve të Komisionit të Venecias. IKD dhe Lëvizja FOL kritikuan projektligjin për cenimin e pavarësisë së KPK-së dhe për rrezikun e bllokadës vendimmarrëse, duke theksuar se këto zgjidhje nuk reflektojnë një reformë të mirëfilltë dhe kanë neglizhuar rekomandimet për një strukturë më të balancuar dhe të pavarur³⁶.

Komisioni i Venecias, në opinionin e publikuar me 18 dhjetor 2023 për Projektligjin e ri për KPK³⁷, nuk i ka mbështetur ndryshimet e reja sa i përket rritjes së përkohshme të numrit të anëtarëve në KPK në 19 anëtarë deri në janar të vitit 2026, ndryshime këto të propozuara me versionin e ri të Projektligjit për KPK, pas ndryshimeve të bëra nga MD³⁸. Pas këtij opinionit, Qeveria dhe Kuvendi ndryshuan qasje, duke zgjedhur një model të uljes graduale të numrit të anëtarëve prokurorë në KPK. Ligji i ri për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për KPK u miratua nga Kuvendi më 11 korrik 2024³⁹.

³³ Po aty, dispozitivi

³⁴ “Ministria e Drejtësisë: Për Gjykatën Kushtetuese më i rëndësishëm interesi i disa anëtarëve të KPK-së se sa interesi i përgjithshëm”; Betimi për Drejtësi, 25 mars 2023; (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ministria-e-drejtësisë-per-gjykatën-kushtetuese-me-i-rëndësishëm-interesi-i-disa-anëtarëve-te-kpk-se-se-sa-interesi-i-pergjithshëm/>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

³⁵ “Ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë përmes deklaratave publike”, Instituti i Kosovës për Drejtësi”, Prishtinë; Dhjetor 2023; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/p-content/uploads/2023/12/Nderhyrjet-ne-sistemin-e-drejtësisë-permes-deklaratave-publike-1-1.pdf>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

³⁶ <https://kli-ks.org/ikd-dhe-fol-projektligji-i-ri-politizim-objektiv-i-keshillit-prokurorial-te-kosoves/>

³⁷ Opinioni

³⁸ “IKD dhe FOL: Projektligji i ri, politizim objektiv i Këshillit Prokurorial të Kosovës”; Instituti i Kosovës për Drejtësi; Prishtinë; 17 korrik 2023; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ikd-dhe-fol-komisioni-i-venecias-si-perkrahu-ndryshimet-e-md-se-per-ritjen-e-perkohshme-te-anëtarëve-te-kpk-se-ne-19-deri-ne-janar-te-vitit-2026/>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

³⁹ “Kuvendi miraton projektligjin për KPK-në, përkundër kritikave nga BE-ja”; Dukagjini, 11 korrik 2024; (Shih linkun: <https://www.dukagjini.com/kuvendi-miraton-projektligjin-per-kpk-ne-perkunder-kritikave-nga-be-ja/>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

Miratimi i Ligjit për KPK solli reagime edhe të partnerëve ndërkombëtarë. Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, kishte deklaruar se Qeveria e Kosovës ka injoruar rekomandimet e BE, KE dhe OSBE për dy projektligje, e që njëri prej tyre ishte ky për KPK-në.

Gjithashtu, shqetësim kishte shprehur edhe BE, duke theksuar se përkundër këshillave dhe mbështetjes së tyre të vazhdueshme që i kanë dhënë qeverisë dhe komisioneve përkatëse të Kuvendit, komentet tona nuk janë marrë parasysh, duke përfshirë ato në lidhje me rritjen e pluralizmit dhe pavarësisë së Komisionit Parazgjedhor për të siguruar përafrimin me standarde evropiane.⁴⁰

Kjo çështje theksohet edhe në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2024. Për këtë ligj thuhet se përkundër këshillave të fuqishme nga BE, Qeveria dhe Kuvendi nuk konsultuan Komisionin e Venecias, ashtu që kjo ka ndikuar negativisht cilësinë e legjislacionit dhe përputhshmërinë me standardet evropiane.⁴¹

Përkundër tërheqjes, eksperimentimi i Qeverisë me reformën për KPK pati koston e saj. Nëse Qeveria ndërhyri në punën e Gjykatës Kushtetuese se iu deshën nëntë (9) muaj për të nxjerrë aktgjykimin përkitazi me Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për KPK, Qeverisë dhe Kuvendit iu deshën mbi 15 muaj për të adresuar gjetjet e GjK.

Edhe Ligji i ri për KPK, që synon uljen graduale të numrit të anëtarëve të KPK, u dërgua nga opozita për vlerësim në GjK⁴². Aktualisht, GjK është duke e shqyrtuar kushtetutshmërinë e këtij Projektligji, i cili do të mbetet pezull deri në vendosjen e kësaj gjykate.

Kështu, përkundër se Kuvendi ka miratuar për herë të dytë Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, ky Ligj ende nuk ka hyrë në fuqi, për shkak se kushtetutshmëria e të njëjtit është duke u shqyrtuar për herë të dytë nga Gjykata Kushtetuese. Kështu, përgjatë kësaj Qeverisje, deri më tani, reforma në KPK ende nuk është jetësuar.

⁴⁰ <https://www.dukagjini.com/kuvendi-miraton-projektligjin-per-kpk-ne-perkunder-kritikave-nga-be-ja/>

⁴¹ “Raporti për Kosovën 2024”; fq. 26; Komisioni Evropian; Bruksel, 30.10.2024; (Shih linkun: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf). (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

⁴² “PDK dërgon në Kushtetuese ligjet për KPM-në, KPK-në dhe statutin për UP-në”; Radio Evropa e Lirë; 18 korrik 2024; (Shih linkun: <https://www.evropaelire.org/a/pdk-kushtetuese-ligje-kpm-kpk-/33041705.html>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024). “LDK-ja i dërgon në Kushtetuese ligjet për KPM-në, KPK-në dhe statutin e UP-së”, Albanian Post; 19 korrik 2024; (Shih linkun: <https://albanianpost.com/ldk-ja-i-dergon-ne-kushtetuese-ligjet-per-kpm-ne-kpk-ne-dhe-statutin-e-up-se/>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

6. Konfiskimi i pasurisë së pajustificueshme

Ndërtimi i mekanizmave për konfiskimin civil të pasurisë së pajustificueshme ishte një prej synimeve të Qeverisë⁴³. Megjithatë, përgjatë gjithë mandatit të saj, Qeveria përfundimisht ende nuk ka arritur ta ndërtojë këtë sistem, që konsiston në miratimin dhe hyrjen në fuqi të Ligjit për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme (Tutje: *Ligji për Byronë*).

Përgjatë mandatit të saj, është kontestuar vazhdimisht nevoja e miratimit të këtij Ligji, janë shkelur rregullat procedurale, janë konstatuar “një mal” problemesh nga Komisioni i Venecias, si dhe është shpallur kundër kushtetues. Përderisa miratimi për herë të dytë nga Kuvendi ngjallë dyshime për përdorim të këtij Ligji për qëllime elektorale.

Fillimisht, duhet theksuar se në asnjë rast, Qeveria nuk ka arritur që në mënyrë të mjaftueshme të argumentoj nevojën për ndërtimin e një sistemi të konfiskimit civil, si në rastin konkret. Sistemi i konfiskimit civil të pasurisë nënkupton sistemin e drejtuar tek pasuria dhe jo tek personi. Ligji për Byronë synon të themelojë një Byro të veçantë për verifikimin e pasurisë së zyrtarëve publik, e cila Byro në rastet kur has në dyshime për pasuri të pajustificueshme, rastin e përcjellë në Gjykatë.

Sistemi i ri i konfiskimit është thënë vazhdimisht se është, ndër të tjera, derivat i mungesës së rezultateve adekuate në fushën e konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme. Në këtë kontekst, Qeveria asnjëherë nuk ka arritur që në mënyrë adekuate të sqaroj se nëse kanë dështuar mekanizmat në fuqi, cila është garancia se nuk do të dështojë edhe një mekanizëm i tretë.

Tutje, sipas Ligjit për Byronë, rastet e iniciuara nga Byroja do të trajtohen në Gjykatë. Qeveria asnjëherë nuk arriti të dëshmojë paradoksalitetin se si ka mundësi që të priten rezultate nga gjyqësori i cili konsiderohet se aq shumë mangësi sa nevojitet një proces i vetingut. Megjithatë, edhe në mungesë të arsytimit të këtyre çështjeve, Qeveria vazhdoi përpjekjet për miratimin e Ligjit për Byronë.

Në dhjetor të vitit 2021, Qeveria kishte miratuar Projekt Ligjin për Byronë. Ky miratim ishte bërë duke shkelur rregullat minimale të konsultimit publik. Këto rregulla ishin shkelur me arsytimin se ky ligj duhet të miratohet brenda vitit 2021⁴⁴.

Në mars 2022, Kryetari i Kuvendit e dërgoi këtë Projektligj për vlerësim në Komisionin e Venecias. Në qershor të po atij viti, Komisioni i Venecias nxorri opinionin përkitazi me këtë Projektligj, duke

⁴³ “Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021 – 2025”, fq. 13, maj 2021, (Shih linkun: <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/06/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

⁴⁴ “Konfiskimi i pasurisë së pajustificueshme: problemet juridike të Projektligjit aktual”; fq. 6; Instituti i Kosovës për Drejtësi; Prishtinë, janar 2022; (Shih linkun: https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/01/IKD_Raporti_Konfiskimi-i-Pasurise-se-pajustificueshme-problemet-juridike-te-projektligjit-aktual-19.01.2022.pdf).

gjetur “një mal” problemesh⁴⁵. Përkundër kësaj, Projektligji nuk u tërhoq nga Ministria e Drejtësisë dhe u tha se gjetjet e Komisionit të Venecias do të adresohen në mes të dy leximeve në Kuvend⁴⁶. Në dhjetor të vitit 2022, Komisioni i Venecias publikoi një opinion përcjellës, ku theksoi se Kuvendi ende kishte rekomandime për të adresuar⁴⁷. Pas zhvillimit të punës në Kuvend, në mars të vitit 2023, Komisioni i Venecias publikoi edhe një opinion përcjellës, ku vlerësoi se ishin zbatuar rekomandimet e dhëna⁴⁸.

Me 9 shkurt 2023, Kuvendi miratoi Ligjin për Byronë. Ky Ligj iu nënshtrua vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Pas 17 muajve, GjK gjeti se Ligji për Byronë nuk ishte në përputhje me Kushtetutën, duke vendosur që ta anulojë të njëjtin si kundër kushtetues⁴⁹.

Në shtator të vitit 2024, Qeveria miratoi Projektligjin e ri për Byronë⁵⁰. Edhe në këtë rast, Qeveria shkeli rregullat minimale në lidhje me procesin e konsultimeve publike, duke vendosur që për këtë Projektligj mos të zhvillojë fare konsultime publike. Kjo u theksua edhe në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2024, ku mes tjerash thuhet se Kuvendi duhet të sigurohet që të ketë konsultime para miratimit të ligjit, ashtu që të sigurojë përputhje me standardet Evropiane⁵¹.

Domosdoshmërisht, ky Ligj është dashur ti nënshtrohej konsultimeve publike. Fillimisht, Rregullorja e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës⁵² është obligative edhe në këtë rast dhe

⁴⁵ ⁴⁵ Komisioni i Venecias, “*Opinion on the concept paper on the vetting of judges and prosecutors and draft amendments to the Constitution: Kosovo*”, Venecia, 17-18 qershor 2022, e miratuar në seancën plenarë të 131-të, (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2022\)011-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2022)011-e)). (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

⁴⁶ “*Haxhiu: Byronë nuk e tërheqim nga Kuvendi, i paprecedentë reagimi i KPK-së*”; Indeksonline; 02 korrik 2022; (Shih linkun: <https://indeksonline.net/%E2%80%8Bhaxhiu-byrone-nuk-e-terheqim-nga-kuvendi-i-paprecedente-reagimi-i-kpk-se/>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

⁴⁷ Komisioni i Venecias; “*Kosovo follow-up opinion to the opinion on the Draft Law No. 08/L-121 on the State Bureau for Verification and Confiscation of Unjustified Assets (CDL-AD(2022)014)*”; par. 34; Miratuar nga Komisioni i Venecias në Seancën Plenare të 133-të; Venecia; 16-17 dhjetor 2022. (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2022\)052-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2022)052-e)); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024)./

⁴⁸ Komisioni i Venecias; “*Kosovo follow-up opinion to the opinion on the Draft Law No. 08/L-121 on the State Bureau for Verification and Confiscation of Unjustified Assets (CDL-AD(2022)052)*”; Prezantuar nga Komisioni i Venecias në Seancën Plenare të 134-të; Venecia; 10-11 mars 2023; (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-PI\(2023\)008-bil](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-PI(2023)008-bil)); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

⁴⁹ Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese në rastin KO46/23 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme; Prishtinë, 29 korrik 2024; (Shih linkun: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2024/07/ko_46_23_agj_shq.pdf); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

⁵⁰ “*Qeveria miraton Projektligjin e ndryshuar për Byronë për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme*”; Prishtinë, 11 shtator 2024; (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/qeveria-miraton-projektligjin-e-ndryshuar-per-byrone-per-konfiskimin-e-pasurise-se-pajustificueshme/>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

⁵¹ “*Raporti për Kosovën 2024*”; fq. 39; Komisioni Evropian; Bruksel, 30.10.2024; (Shih linkun: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf). (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

⁵² Rregullorja

nuk përmban asnjë dispozitë e cila e liron Qeverinë nga ky obligim. Në anën tjetër, ndonëse GjK ka gjetur shkelje vetëm në disa nene kushtetuese, Qeveria duket se nuk e pati parasysh rëndësinë e këtyre çështjeve: Këto çështje të identifikuar nga GjK ishin aq problematike sa GjK për shkak të tyre vendosi ta anuloi Ligjin në tërësi. Për këtë arsye, edhe në këtë rast, Qeveria veproi në kundërshtim me rregullat minimale të konsultimeve publike, duke përjashtuar gjithëpërfshirjen në draftimin dhe miratimin e këtij Projektligji.

Përjashtimi i akterëve relevantë dhe publikut në lidhje me Projektligjin për Byronë ka vazhduar edhe në Kuvend. Për afër tre (3) muaj, ky Projektligj nuk u shqyrtua nga Kuvendi. Megjithatë, më 5 dhjetor 2024, u vendos që ky Projektligj të miratohej me procedurë të përshpejtuar, duke mos u lejuar puna në mes të dy leximeve, ashtu që në të njëjtën ditë, Kuvendi miratoi në Ligjin për Byronë në dy leximet⁵³.

Kjo mënyrë e veprimit nga ana e Kuvendit në raport me Byronë tregon për një tendencë të hapur të Qeverisë dhe Kuvendit për të përjashtuar palët e interesuara dhe publikun nga përfshirja në draftimin e këtij Ligji. Në rastin e Projektligjit të parë, Qeveria kishte cenuar dispozitat që kanë të bëjnë me konsultimet publike derisa në rastin e dytë, këto dispozita nuk ishin aplikuar fare. Ndërsa, Kuvendi e miratoi Ligjin për Byronë në të dy leximet në të njëjtën ditë, duke mos lejuar hapësirë për palët e interesuar dhe publikun.

Mënyra e veprimit të Qeverisë dhe Kuvendit në raport me Ligjin për Byronë, ku Projektligji në fjalë nuk trajtohet për afër tre muaj dhe pastaj miratohet në të njëjtën ditë në të dy leximet, krijon perceptimin e përdorimit të Ligjit për Byronë si mjet për qëllime elektorale dhe jo si veprim për të avancuar sundimin e ligjit në Kosovë.

Sa i përket Ligjit të miratuar nga Kuvendi me 5 dhjetor 2024, palët e autorizuar kanë mundësi që përsëri ta atakojnë këtë Ligj në Gjykatën Kushtetuese.

7. Deklarata e përbashkët e zotimeve

Me qëllim që të vazhdohet me reformën në drejtësi, MD, KGjK, Gjykata Supreme dhe Kryeprokurori i Shtetit me 14 mars 2023 kanë nënshkruar Deklaratën e Përbashkët të Zotimeve.⁵⁴

⁵³ “Miratohet edhe në lexim të dytë Projektligji për Byronë, votojnë pro 62 deputetë”; Betimi për Drejtësi; 05 dhjetor 2024; (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/miratohet-edhe-ne-lexim-te-dyte-projektligji-per-byrone-votojne-pro-62-deputete/>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

⁵⁴ “Nënshkruhet deklarata e përbashkët e zotimit për reformën ligjore në sistemin e drejtësisë në mes të Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës, Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurorit të Shtetit”. Këshilli Gjyqësor i Kosovës. 14 mars 2023. (Shih linkun: <https://www.gjyqesor-rks.org/2023/03/14/nenshkruhet-deklarata-e-perbashket-e-zotimit-per-reformen-ligjore-ne-sistemin-e-drejtises-ne-mes-te-ministrise-se-drejtises-keshillit-gjyqesor-te-kosoves-keshillit-prokurorial-te-kosoves-gjyqesore/>). (Qasur për herë të fundit më 29 qershor 2024).

Në deklaratë ndër të tjera theksohej se këto institucione janë zotuar për të vazhduar reformën në drejtësi përmes punës së përbashkët për vlerësimin, konceptualizimin dhe hartimin e nismave ligjore me synimin e përbashkët për të qartësuar, plotësuar, ndryshuar dhe fuqizuar kuadrin ligjor në disa fusha.

Fushat për të cilat ishin pajtuar të bënin reformë kërret e institucioneve, kishin të bënin me vlerësimin e performancës, procesin e rekrutimit, emërimit dhe rrimërimit, sistemin e disiplinimit, procesin e verifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, zhvillimin profesional, forcimin e mekanizmave për deklarim të pasurisë për gjyqtarë dhe prokurorë, statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, hartimin e ligjit për nëpunësit civil në administratën e gjykatave dhe prokurorive, zbatimin e rekomandimeve nga Misioni i TAIEX për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit etj.

Për skanimin dhe vlerësimin e ligjeve në sistemin e drejtësisë ishin themeluar gjashtë (6) grupe punuese. Në fund të janarit 2024⁵⁵ përmes një punëtorie ishte paraqitur një draft raport i përmbledhjes së raporteve të grupeve punuese.⁵⁶ Pas këtij drafti, me 14 shkurt 2024 ishte mbajtur edhe një grup tjetër punues, ku ishte diskutuar lidhur me konceptdokumentet.⁵⁷ Takimet e përbashkëta mes nënshkruesve të deklaratës kishin vazhduar deri me 20 mars 2024, ku përfaqësuesit e sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial kishin lëshuar punëtorinë duke mos u pajtuar me draftet e projektligjeve dhe ligjeve që ishin sjellur nga MD-ja.⁵⁸ Madje, KPK kishte dal me një reagim publik duke e kritikuar MD për qasje jo bashkëpunuese dhe për mospërmbajtje të Deklaratës së Përbashkët të Zotimeve. Po ashtu, KPK kishte reaguar edhe për gjuhën tendencioze që ishte përdorur nga zv. Ministri i Drejtësisë.⁵⁹

Që nga nënshkrimi i Deklaratës së Përbashkët të Zotimeve e deri më tani kanë kaluar afërsisht 21 muaj. Nga qëllimi që reforma në drejtësi të bëhet nga MD-ja së bashku me kërret e KGJK-së dhe KPK-së, Ministria e Drejtësisë ka përfunduar e vetme në tentativën e saj për reformë në drejtësi. Megjithatë, as si e vetme, këtë reformë nuk e ka jetësuar.

⁵⁵ “Grupi Punues për Reformë në Drejtësi mbajti takimin e radhës”. Ministria e Drejtësisë. 31 janar 2024. (Shihlinkun:<https://www.facebook.com/MinistriaeDrejtësisë/posts/pfbid02CgNiWkntZHYCFWHTECv9Q8cvASdXnkDSMT2XJq6hrvynMZUxkRG4Prd1Pc8JUK1>). (Qasur për herë të fundit më 29 qershor 2024).

⁵⁶ **Shënim:** Në këtë punëtori të mbajtur me 31.01.2024 nuk kishte marr pjesë asnjë përfaqësues i sistemit prokurorial. ⁵⁷“Vazhdon puna e Grupit Punues për Reformën në Drejtësi”. Ministria e Drejtësisë”. 14 shkurt 2024. (Shihlinkun:<https://www.facebook.com/MinistriaeDrejtësisë/posts/pfbid029vboUFccMMJk8DQyAGA7rvVUGCmBupVdziGhGCqH5Y2MZik7TqdZLPakn4usrE11>). (Qasur për herë të fundit më 29 qershor 2024).

⁵⁸ “Diskutohen draftet e para të dokumenteve që rrjedhin nga Deklarata e Përbashkët e Zotimeve”. Ministria e Drejtësisë. 20mars2024. (Shihlinkun:<https://www.facebook.com/MinistriaeDrejtësisë/posts/pfbid0XbPgFn1BTi6G16SSLggCC8gIRFj6g815jZtKtwCxbN7z1XcSaPMBXp688VwLE8JDI>). (Qasur për herë të fundit më 29 qershor 2024).

⁵⁹ “Reagim i Këshillit Prokurorial të Kosovës”, Sistemi Prokurorial. 21 mars 2024. (Shih linkun: <https://www.facebook.com/share/p/ut3fXgZkRMcqGYcB/>). (Qasur për herë të fundit më 29 qershor 2024).

Përkundrazi, Projektligjet e publikuara në mënyrë jo adekuate për konsultime publike⁶⁰ përbënin shkelje kushtetuese.

Sa i përket Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit 06/L -057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, IKD ka gjetur se MD është referuar vetëm në draft amendamente, të cilat nuk janë miratuar dhe si rrjedhojë, nuk janë pjesë e Kushtetutës, po ashtu ka përzier përgjegjësinë disiplinore me atë penale etj⁶¹.

Shkelje kushtetuese janë identifikuar edhe në Projektligjin për Rekrutimin, Vlerësimin e Performancës, Kontrollin e Integritetit, Avancimin dhe Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. IKD ka gjetur edhe ky projektligj ishte referuar në draft amendamente kushtetuese, kishte lënë prokurorët pa imunitet, përmbante dispozita diskriminuese etj⁶².

Probleme përmbanin edhe Projektligjet e tjera, disa prej të cilave synonin edhe politizimin e procesit të verifikimit të zyrtarëve të Njësive për Verifikim të Integritetit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, politizimin e Akademisë së Drejtësisë etj⁶³.

Në lidhje me këtë proces, Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën theksoj se “Zbatimi i Deklaratës së Përbashkët të Zotimeve, e nënshkruar nga drejtuesit e institucioneve të sistemit të drejtësisë në mars 2023, hasi në pengesa dhe vonesa serioze. Procesi i hartimit të këtyre ligjeve kyçe të reformës nuk siguroi një konsultim domethënës me palët relevante vendore dhe ndërkombëtare. Pavarësisht këshillave të fuqishme të BE-së, Komisioni i Venecias nuk u konsultua nga qeveria mbi paketën e reformës legjislativë. Kjo ndikoi negativisht në cilësinë e tyre dhe përshtatshmërinë me standardet evropiane. Një legjislacion i tillë kyç kërkon vlerësim nga Komisioni i Venecias. Në veçanti, projektligji i propozuar për vlerësimin e performancës, kontrollin e integritetit dhe statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ka mangësi në qartësi dhe shqetësimet mbeten se fusha e tyre nuk është në përputhje me standardet evropiane”⁶⁴.

⁶⁰ “Problemet e reformës në drejtësi – (Analizë e katër Projektligjeve që dalin nga “Deklarata e Përbashkët e Zotimeve”); fq. 12; Instituti i Kosovës për Drejtësi; Prishtinë, korrik 2024; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/07/PROBLEMET-E-REFORMES-NE-DREJTESI-Analize-e-kater-Projektligjeve-qe-dalin-nga-Deklarata-e-Perbashket-e-Zotimeve.pdf>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

⁶¹ “Llogaridhënia ((Problemet kushtetuese dhe ligjore të Projektligjit aktual)”; Instituti i Kosovës për Drejtësi; Prishtinë; Korrik 2024; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/07/Llogaridhenia-Problemet-kushtetuese-dhe-ligjore-te-Projektligjit-aktual-1-1.pdf>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

⁶² Integriteti i gjyqtarëve dhe prokurorëve ((Problemet kushtetuese dhe ligjore të Projektligjit aktual)”; Instituti i Kosovës për Drejtësi; Prishtinë; Korrik 2024; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/07/Integriteti-i-gjyqtareve-dhe-Prokurorëve-Problemet-kushtetuese-dhe-ligjore-te-Projektligjit-aktual-6.pdf>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

⁶³ “Problemet e reformës në drejtësi – (Analizë e katër Projektligjeve që dalin nga “Deklarata e Përbashkët e Zotimeve”); fq. 12; Instituti i Kosovës për Drejtësi; Prishtinë, korrik 2024; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/07/PROBLEMET-E-REFORMES-NE-DREJTESI-Analize-e-kater-Projektligjeve-qe-dalin-nga-Deklarata-e-Perbashket-e-Zotimeve.pdf>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

⁶⁴ “Raporti për Kosovën 2024”; fq. 26; Komisioni Evropian; Bruksel, 30.10.2024; (Shih linkun: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43e1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf). (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

Pas fazës së konsultimeve publike, e cila fazë ka mbaruar me 2 korrik 2024, MD nuk ka proceduar tutje me miratimin e këtyre Projektligjeve. Megjithatë, MD i ka dërguar këto Projektligje për Vlerësim në Komisionin e Venecias.

Kështu, përkundër zotimit për zhvillim të reformës së bashku me institucionet e sistemit të drejtësisë, MD ka mbetur e vetme në këtë proces. Madje, as si e vetme, nuk ka arritur që të përmbyllë Projektligje jashtëzakonisht të rëndësishme të cilat kanë të bëjnë me gjyqësorin. Për më tepër, draftet e publikuara për konsultim publik përmbanin shkelje të shumta kushtetuese dhe probleme të tjera.

Kështu, Qeveria e Republikës së Kosovës dështoi të miratojë gjashtë (6) projektligje jashtëzakonisht të rëndësishme për sistemin e drejtësisë, duke e lënë sistemin e drejtësisë të pa reformuar.

8. Dështimi strategjik

“Karakter i planifikimit tregon për karakterin e qeverisjes” do të deklaronte kreu i Qeverisë në një ngjarje⁶⁵. Sipas kësaj fraze, të përdorur nga vet Kryeministri, në fushën e sundimit të ligjit, karakteri i qeverisjes del të jetë jashtëzakonisht problematik.

Në kuptim të planifikimit strategjik, Kosova nuk ka Strategji kundër Korrupsionit, miratimin e të cilës ka dështuar ta bëjë Qeveria. Duke trashëguar Procesin e RFSSL, Qeveria ka miratuar SSL 2021-2026. Por, mos veprimi i Qeverisë e ka bërë Strategji të pazbatuar në praktikë. Për shkak të keqplanifikimit, katër (4) vite pas, ekzistojnë ende probleme ligjore të cilat kanë pasur mundësi të adresohen në fillim të mandatit. Punimi në dy drejtime, në të njëjtën kohë, për të njëjtin Ligj, nuk do duhej të tregonte një karakter të mirë të qeverisjes, nëse bazohemi në kriterin e karakterit të planifikimit.

Këto çështje do të trajtohen në vijim të këtij raporti.

a. Kosova pa Strategji kundër Korrupsionit

Luftimi i korrupsionit ka qenë njëra prej premtimeve kryesore me të cilat ka ardhur në pushtet Lëvizja Vetëvendosje. “Drejtësi dhe Punësim” ishte slogani kryesor i kësaj partie gjatë fushatës elektorale. Edhe përkundër faktit se Qeveria Kurti II luftimin e korrupsionit e kishte proklamuar si qëllimin kryesor, në fundin e mandatit qeverisës, Kosova ende nuk ka një Strategji për Luftimin e Korrupsionit dhe publiku ende nuk e ka të qartë se cila do të jetë rruga që Qeveria do të ndjek në raport me luftimin e korrupsionit në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që kjo qeveri ka në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Mungesa e kësaj Strategjie gjatë mandatit qeverisës dhe dështimi i grupit punues për të hartuar një dokument të bazuar në ligjin e aplikueshëm në

⁶⁵ “Kurti: Transformimi shoqëror nuk arrihet pa planifikim të kujdesshëm”; Koha; 25 tetor 2021; (Shih linkun: <https://www.koha.net/arberi/kurti-transformimi-shoqeror-nuk-arrihet-pa-planifikim-te-kujdesshem>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

Kosovë, dhe i cili dokument nuk ndërhyt në pavarësinë dhe integritetin e institucioneve të pavarura, ndërton bindjen se vet qeveria dhe grupi punues kanë probleme serioze për të kuptuar kompetencat e tyre dhe për të përmbushur obligimet që dalin nga Programi i Qeverisë për luftimin e korrupsionit. Në fakt, mungesa e kësaj Strategjie tregon se gjatë mandatit, as vet Qeveria nuk e ka pasur të qartë rrugën që duhet ndjekur në luftimin e korrupsionit.

Ligji Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit ka hyrë në fuqi në Gusht të vitit 2022. Strategjia shtetërore dhe plani i veprimit kundër korrupsionit në përputhje me nenin 24 të këtij Ligjit hartohet dhe miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Përderisa, zbatimin e Strategjisë kundër korrupsionit, e monitoron Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2023 kishte marrë vendim për themelimin e strukturave për hartimin e Strategjisë Shtetërore dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit. Kjo strukturë përbëhet prej Komisionit Ministror, Koordinatorit dhe Grupit punues. Me ç' rast grupi punues përbëhet prej akterëve të rëndësishëm shtetëror, duke përfshirë dhe agjencitë e pavarura dhe institucionet tjera sipas nevojës. Ky grup punues, sipas këtij vendimi, duhet ta draftonte këtë Strategji deri më 1 dhjetor 2023.

Përgjatë kohës sa është hartuar Draft Strategjia Kombëtare kundër Korrupsionit dhe Planit i Veprimit 2023-2026, (Tutje: Draft Strategjia) IKD ka marrë pjesë në të gjitha takimet ku është ftuar si dhe ka dërguar edhe komentet me shkrim, duke synuar dhënien e kontributit drejt hartimit të një Strategjie që i përgjigjet nevojës për luftimin e korrupsionit. Përkundër kësaj, narrativi i Draft Strategjisë u bë i njohur për IKD vetëm në takimin e datës 7 nëntor 2023, gjatë të cilit takim, fillimisht, u tha se ishte i takimi i fundit lidhur me këtë Draft Strategji. IKD dha komentet e saj në këtë takim dhe të njëjtat i procedoj edhe me shkrim. IKD nuk morri asnjëherë përgjigje mbi mënyrën e trajtimit të këtyre komenteve.

Afati për miratimin e Strategjisë kundër korrupsionit, 1 dhjetor 2023, nuk u respektua. Sidoqoftë, grupi punues vazhdoi punën dhe IKD morri pjesë në takimet e këtij grupi punues sa her që u ftua. Madje, IKD shprehi përkrahjen e saj duke draftuar njërin prej kapitujve të kësaj Strategji. Përsëri, IKD nuk morri asnjëherë përgjigje për mënyrën e trajtimit të komenteve të parashtruara dhe kapitullit të draftuar.

Kështu, Qeveria vazhdoi të hesht përballë detyrës elementare që kishte: Miratimin e Strategjisë kundër Korrupsionit. Ndonëse miratimi i Strategjisë mbetet obligim ligjor, tanimë miratimi i saj nuk ka asnjë kuptim. Strategjia supozohet të jetë një dokument strategjik që planifikon veprimet për një fushë të caktuar. Miratimi i këtij dokumenti në kohën kur Qeveria vetëm se po përfundon mandatin e saj do të ishte haptazi vetëm një veprim për qëllime elektorale. Kjo pasi një Strategji e tillë normalisht se nuk ka kuptim nëse miratohet rreth dy (2) muaj para datës së mbajtjes së zgjedhjeve të përgjithshme.

Në anën tjetër, draftet e prezantuara nga grupi punues kishin probleme të cilat mund të cilësohen si probleme të papara më parë në historinë e Kosovës. Këto drafte përmbanin probleme lidhur me mënyrën e trajtimit të disa çështjeve konceptuale. I tillë ishte rasti lidhur me monitorimin e punës së KGJK dhe KPK nga Gjykata Kushtetuese apo përzierja e koncepteve lidhur me pronarin përfitues dhe pronësinë mediale. Përkundër faktit se Draft Strategjia e nënvizonte nevojën që të shtrihet vetëm në ato segmente që mund të trajtohen nga mekanizmat dhe mjetet qeveritare, draftet përmbanin çështje të cilat janë në kompetencë të institucioneve të sistemit të drejtësisë.

Tutje, në shumë raste, draftet kishin pasaktësi faktike. I tillë p.sh është rasti kur thuhet se nuk ekzistojnë dispozita për obligueshmërinë e kthimit të përgjigjeve lidhur me rezultatin e kallëzimeve penale, mungesës së dispozitave lidhur me pronarin përfitues etj. Apo, është rasti kur thuhet se disa probleme do të trajtohen përmes Ligjit për Evidenca Penale, ku më pastaj përfshihen edhe çështje të cilat fare nuk kanë të bëjnë me këtë Ligj. Tutje, ndonëse supozohet se një dokument strategjik shtrihet në të ardhmen, në kuptim të objektivave që synon, draftet e prezantuara përmbanin çështje tanimë të përfunduara⁶⁶.

Siç u tha, mungesa e Strategjisë kundër Korrupsion tregon faktin se as Qeveria nuk e kishte të njohur rrugën që kishte për të ndjekur në këtë fushë, ndonëse luftimi i korrupsionit ishte një prej premtimeve bazë të Qeverisë aktuale. Në anën tjetër, problemet e shprehura në Draft Strategjitë e pranuar na sjellë detyrimisht tek nevoja për vlerësimin në mes të dy (2) çështjeve, asnjëra prej të cilave nuk do të duhej të konsiderohej e pranueshme: Në mes të problemit lidhur me mungesën e Strategjisë kundër Korrupsionit dhe problemeve që përmbajnë draftet e prezantuara, fatkeqësisht, mund të thuhet se është më mirë që Kosova nuk ka fare Strategji se sa të kishte, ashtu siç u prezantua, një Strategji që cenon bazat e ndërtimit të sistemit kushtetues kosovar.

b. Strategjia për Sundimin e Ligjit

Qeveria aktuale e Republikës së Kosovës trashëgoi një punë jashtëzakonisht të mirë nga Qeveritë paraprake: Procesin e Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit (Tutje: RFSSL). RFSSL është njëra prej iniciativave më të mëdha për avancimit e sundimit të ligjit në Kosovë. Kjo u konstatua edhe në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2020, ku RFSSL u konsiderua si bazë e shëndoshë për reformim të sistemit gjyqësor. Procesi i RFSSL-së rezultoi me një strategji dhe plan të veprimit për sundimin e ligjit, dokumente të cilat u miratuan nga Qeveria e Kosovës, me 11 gusht të vitit 2021. SSL dhe Plani Veprimit listuan aktivitetet që duhej zbatoheshin nga institucionet përkatëse⁶⁷.

⁶⁶ “Kosova pa Strategji kundër Korrupsionit (Dështimi i Qeverisë për miratimin e Strategjisë kundër Korrupsionit dhe komentet e IKD lidhur me Draft Strategjinë kundër Korrupsionit”; Instituti i Kosovës për Drejtësi; Prishtinë, janar 2024; (Shih linkun: https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/01/IKD_Kosova-pa-Strategji-kunder-Korrupsion-final.pdf); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

⁶⁷ “(Mos) Zbatimi i Strategjisë së Sundimit të Ligjit në Praktikë”; fq. 11; Instituti i Kosovës për Drejtësi; tetor 2023; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/10/Mos-Zbatimi-i-Strategjise-se-Sundimit-te-Ligjit-ne-Praktike-1.pdf>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

Kështu, pjesë e kësaj strategjie ishte edhe Plani i saj i Veprimit për vitet 2021-2023. Plani i Veprimit përmbante aktivitetet specifike, elaboronte në hollësi objektivat strategjike dhe specifike, veprimet, institucionet përgjegjëse, koston financiare për zbatim si dhe treguesit⁶⁸. Por, ky plan ka skaduar në fund të vitit 2023.

Fillimisht, duhet theksuar se vet SSL ka përcaktuar se rishikimi afatmesëm i Planit të Veprimit do të bëhet “...jo më larg se deri në fillim të vitit 2024...”. Në çfarëdo interpretimi, më së largu, fillimi i vitit mund të konsiderohet fundi i muajit mars të vitit përkatës, përkatësisht përfundimi i tremujorit të parë. Në këtë logjikë, procesi i rishikimit afatmesëm të Strategjisë është dashur të përfundohej deri më 31 mars 2024⁶⁹.

Ky obligim i Strategjisë nuk është përmbushur. Si rrjedhojë, SSL ka mbetur pa Plan të Veprimit. SSL, në mënyrë se si është ndërtuar, nuk është vetvetiu e zbatueshme, pa një Plan të Veprimit i cili liston specifikisht aktivitetet që duhet t’i kryejnë institucionet, me qëllim të zbatimit të objektivave të përcaktuara nga SSL. Kështu, dështimi për të bërë vlerësimin afatmesëm të SSL-së dhe dështimi për të miratuar Planin e ri të Veprimit e ka bërë SSL një dokument të pa implementueshëm në praktikë.⁷⁰

Me 1 tetor 2024 Ministria e Drejtësisë ka publikuar për konsultime publike Draft Rishikimin Afatmesëm të SSL 2021-2026. Procesi i konsultimeve publike lidhur me këtë plan është mbyllur më 21 tetor 2024. IKD ka dërguar komentet e saj në lidhje me këtë draft⁷¹.

Megjithatë, deri më sot, Qeveria nuk e ka miratuar Planin e ri të Veprimit. Kështu, përgjatë vitit 2024, SSL nuk ka qenë e zbatueshme. Kjo qasje e Qeverisë ia humbi SSL një vit, që në kuptimin e masës kohore, paraqet humbje prej 20% të periudhës kohore në të cilën SSL duhet të zbatohet. Kjo qasje cenon në thelb efektivitetin e SSL dhe madje rrezikon edhe afektimin e aktiviteteve që do të përcaktohen në vitet vijuese.

Kjo u theksua edhe në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2024, ku thuhet se Kosova ka një Strategji për Sundimin e Ligjit për 2021 -2026, por se Plani i Veprimit për 2024 – 2026 është vonuar⁷².

⁶⁸ Strategjia për Sundimin e Ligjit, f.41

⁶⁹ “Strategjia në udhëkryq (Raport i monitorimit të zbatimit të strategjisë për sundimin e ligjit dhe planit të veprimit)”; fq. 11-12; Instituti i Kosovës për Drejtësi; qershor 2024; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/06/STRATEGJIA-NE-UDHEKRYQ-Raporti-i-monitorimit-te-Strategjise-per-Sundimin-e-Ligjit-dhe-Planit-te-Veprimit.pdf>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

⁷⁰ Po aty.

⁷¹ Konsultimi publik “Rishikimi afatmesëm i Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2021-2026”; 7 dhjetor 2024; (Shih linkun: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42621>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

⁷² “Raporti për Kosovën 2024”; fq. 26; Komisioni Evropian; Bruksel, 30.10.2024; (Shih linkun: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43e1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

Kështu, në raport me SSL, Qeveria dështoi strategjikisht, duhet mos e miratuar dokumentin që e jetëson SSL, Planin e Veprimit. Në këtë mënyrë, përgjatë vitit 2024, mos veprimi i Qeverisë bëri që SSL të shndërrohej në një dokument të pazbatuar në praktikë.

Në anën tjetër, edhe në kuptim të zbatimit të Planit të Veprimit 2021-2023, IKD kishte gjetur probleme të shumta, që konsistonin në shkeljen e kësaj SSL, raportimin e pasaktë në lidhje me zbatimin e SSL etj⁷³.

c. Planifikimi paradoksal

Në jo pak raste, mungesa e një planifikimi adekuat të Qeverisë bëri që veprimet e Qeverisë të reflektonin një planifikim paradoksal. I tillë është rasti kur në kohën sa Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për KPK ishte duke u shqyrtuar në Kuvend, ndryshimi i po këtij Ligji ishte po ashtu pjesë e trajtimit në kuadër të reformës sipas deklaratës së përbashkët⁷⁴.

MD kishte iniciuar plotësim/ndryshimin e LPDGjP. Ky Projektligj ishte publikuar më 26 tetor 2020, në Platformën e Konsultimeve Publike. Sipas këtij Projektligji, në LPDGjP do të ndryshohej vetëm një nen. Duke mirëpritur ndryshimin e propozuar nga MD, IKD kishte paraqitur 12 faqe komente mbi nevojat e LPDGjP për tu ndryshuar/plotësuar. Këto komente kishin ardhur pasi IKD kishte evidentuar sfidat praktike të zbatimit të LPDGjP nga monitorimi i këtij Projektligji, monitorim ky bërë nga afër përmes parashtrimit të ankesave disiplinore. Këto nevoja në raport me avancimin e LPDGjP janë injoruar nga MD, si në mandatin e z. Selimi ashtu edhe në mandatin e znj. Haxhiu. Kjo e fundit, ka dërguar për miratim në Qeveri Projektligjin me vetëm një ndryshim, duke injoruar të gjitha shqetësimet e ngritura nga IKD. Projektligji me vetëm një ndryshim është miratuar nga Qeveria më 21 prill 2021 dhe i njëjti është miratuar nga Kuvendi dhe ka hyrë në fuqi më 5 nëntor 2021.

Kështu, nevojat për reformimin e sistemit të llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve, përmes plotësimit dhe ndryshimit të LPDGjP kanë qenë evidente edhe në atë kohë. Megjithatë, MD injoroi të gjitha këto nevoja, duke përmbushur vetëm formalisht Agjendën Legjislative, por jo edhe duke adresuar në mënyrë reale problemet e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Kështu, që nga miratimi i Ligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e LPDGjP e deri më sot, kanë kaluar mbi tri (3) vite dhe Ligji në fjalë nuk është reformuar. Përgjatë gjithë kësaj kohe, sistemi i disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve ka qenë i mangët, për shkak të mos reformimit

⁷³ “(Mos) Zbatimi i Strategjisë së Sundimit të Ligjit në Praktikë”; Instituti i Kosovës për Drejtësi; tetor 2023; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/10/Mos-Zbatimi-i-Strategjise-se-Sundimit-te-Ligjit-ne-Praktike-1.pdf>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024); “Strategjia në udhëkryq (Raport i monitorimit të zbatimit të strategjisë për sundimin e ligjit dhe planit të veprimit)”; Instituti i Kosovës për Drejtësi; qershor 2024; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/06/STRATEGJIA-NE-UDHEKRYQ-Raporti-i-monitorimit-te-Strategjise-per-Sundimin-e-Ligjit-dhe-Planit-te-Veprimit.pdf>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

⁷⁴ “Problemet e reformës në drejtësi – (Analizë e katër Projektligjeve që dalin nga “Deklarata e Përbashkët e Zotimeve”); fq. 14; Instituti i Kosovës për Drejtësi; Prishtinë, korrik 2024; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/07/PROBLEMET-E-REFORMES-NE-DREJTESI-Analize-e-kater-Projektligjeve-qe-dalin-nga-Deklarata-e-Perbashket-e-Zotimeve.pdf>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024)

të këtij Ligji. P.sh. gjatë gjithë kësaj kohe, nuk ka pasur mekanizëm për ankimim ndaj vendimeve të autoriteteve kompetente⁷⁵.

9. Mos prioritizimi buxhetor i drejtësisë

Në plan programin me të cilën partia në pushtet kishte garuar në zgjedhjet e vitit 2021, ajo zotohet për mbështetje financiare dhe fuqizim të institucioneve të sistemit të drejtësisë. Krahas të tjerave, ky dokument thekson: “Qeveria jonë do të dëshmojë përkushtim në luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe në këtë drejtim do të shtohen kapacitetet njerëzore dhe profesionale në Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore ne Prishtine dhe asaj të Apelit. Kjo do të mundësohet përmes mbështetjes financiare për sistemin e drejtësisë me qëllim të plotësimit të nevojave të tyre.... Krahas vlerësimit të nevojave në sistemin gjyqësor, duke pasur parasysh rëndësinë, Qeveria do të shtoj kapacitetet e Prokurorisë Speciale... Po ashtu, do të shtohen kapacitetet njerëzore dhe profesionale edhe në departamentet për krim të organizuar, korrupsion dhe krime financiare në kuadër të Prokurorisë Speciale... Numri i prokurorëve në Prokurorinë speciale dhe bashkëpunëtorëve profesional në raport me lëndët që trajtohen në këtë prokurori është shumë i vogël”⁷⁶.

Megjithatë, në aspektin buxhetor, Qeveria nuk i ka dhënë prioritet drejtësisë. Përkundër faktit se sipas Ligjit, secili gjyqtar ⁷⁷ dhe prokurorë⁷⁸ duhet të ketë nga një bashkëpunëtorë profesional, sistemi i drejtësisë ende nuk ka mjete të mjaftueshme buxhetore për këtë. Qeveria nuk i është përgjigjur asnjë prej kërkesave buxhetore të KGjK në lidhje me draft buxhetin për vitin 2024, ku bën pjesë kërkesa për mjete buxhetore shtesë për gjyqtarë të rinjë, përkthyes etj. , në jo pak raste, Kuvendi ka qenë i kënaqur me miratimin e këtyre ligjeve, por nuk ka ndarë buxhet të mjaftueshëm që këto ligje të zbatohen në praktikë. I tillë është rasti me miratimin e Kodit të ri të Procedurës Penale dhe Ligjit për Gjykatën Komerciale⁷⁹.

Nga viti 2021 deri në vitin 2024, buxheti për sistemin e drejtësisë është rritur vazhdimisht. Krahasuar me vitin 2021, buxheti për vitin 2024 është 6,612.318 euro më i lartë. Megjithatë, rritja e përgjithshme e shpenzimeve të qeverisë sipas ligjeve për ndarjen e buxhetit nuk është pasqyruar proporcionalisht as në sistemin gjyqësor. Në vitin 2021 dhe 2022, pjesëmarrja e buxhetit të sistemit

⁷⁵ “Llogaridhënia ((Problemet kushtetuese dhe ligjore të Projektligjit aktual)” fq. 10; Instituti i Kosovës për Drejtësi; Prishtinë; Korrik 2024; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/07/Llogaridhenia-Problemet-kushtetuese-dhe-ligjore-te-Projektligjit-aktual-1-1.pdf>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

⁷⁶ Programi zgjedhor i LVV-së, “Prioritet për krejt qytetarët DREJT së ardhmes”, fq. 28-29, shkurt 2021, (Shih linkun: <https://www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2024/08/Prioritetet-per-KREJT-qytetaret-Drejt-se-ardhmes.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

⁷⁷ neni

⁷⁸ Neni

⁷⁹ “Drejtësia me qytetarin në qendër për të përshkallëzuar investimin në atë që funksionon për ta realizuar OZhQ-në 16.3 në Kosovë”; fq. 15 – 24; Instituti i Kosovës për Drejtësi; Shtator 2024; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/09/Drejtësia-me-qytetarin-ne-qender-%E2%80%93-per-te-shkallezuar-investimin-ne-ate-qe-funksionon-per-ta-realizuar-OZhQ-ne-16.3-ne-Kosove-AK-NJ-GZ.pdf>); (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2024).

të drejtësisë në shumën totale të shpenzimeve të qeverisë ka qenë 1,2%. Në anën tjetër, kjo përqindje ka rënë në 1.1% në vitin 2023 dhe 2024. Po ashtu, edhe krahasuar me shpenzimet buxhetore për institucionet qendrore, përqindja e buxhetit të sistemit të drejtësisë në vitin 2024 është më e ulët krahasuar me vitin 2022⁸⁰.

Nga viti 2021 deri në vitin 2024, buxheti për KPK është rritur për 2,824,339 euro. Përkundër rritjes së përgjithshme të shpenzimeve, në vitin 2021 pjesëmarrja në shpenzimet e buxhetit të përgjithshëm nuk kalonin më shumë se 0.7% për KPK, derisa kjo përqindje ka rënë në 0.5% për vitin 2024.

Kështu, krahas dështimit në reformimin e sistemit të drejtësisë, Qeveria dhe Kuvendi nuk e trajtuan drejtësinë si prioritet në buxhetin e tyre.

⁸⁰ Po aty, fq.12.